



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjiilan.net tel: 0280390112

Ven. nr. 01/2317 Dt. 15/11 / 2022

Në mbështetje të nenit 15 paragrafi 20 dhe 21 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ, ref.nr. 01/742 dt.28.04.2022, Senati në mbledhjen e XXXVIII të radhës të mbajtur më datë 10.11.2022, mori:

V E N D I M

Refuzohet Raporti i Komisionit të Ankesave dhe Parashtresave të Senatit nr. 05/2227 dt.07.11.2022.

Arsyetim

Senati në mbledhjen e XXXVIII të radhës të mbajtur më datë 10.11.2022, ka refuzuar raportin e Komisionit të Ankesave dhe Parashtresave të Senatit nr. 05/2227 dt.07.11.2022, me të cilin raport aprovohet ankesa nr.05/1862, dt.13.10.2022 e Sefedin Rahimi për zgjedhjen e tij si mësimdhënës në Fakultetin Edukimit për lëndët: Histori kombëtare (Programet: Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor); Metodologji e shkencave shoqërore (programet: Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor); Metodologji e hulumtimit shkencor (programet master: Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor dhe Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe) në Fakultetin e Edukimit në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjiilan.

Senati me rastin e refuzimit të raportit të Komisionit të Ankesave dhe Parashtresave të Senatit ka konstatuar, se komisioni ka gabuar me rastin e aprovimit të ankesës sepse konkursi ka qenë i shpallur për lëndë nga fusha të ndryshme, pra për lëndët: Histori kombëtare (Programet: Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor); Metodologji e shkencave shoqërore (programet: Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor); Metodologji e hulumtimit shkencor (programet master: Mësimdhënie dhe Kurrikula në Arsimin Fillor dhe Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe) dhe kandidati i propozuar nga Komisioni Recensues, Këshilli i Fakultetit, Komisioni i Studimeve dhe i votuar nga Senati Dr.sc. Sylë Ukshini i plotëson të gjitha kushtet për tu zgjedhur në thirrjen akademike Profesor Asistent.

Senati ka konstatuar se programet në Fakultetin e Edukimit i mbulojnë të gjitha fushat kurrikulare dhe sipas konkursit nuk është kërkuar mësimdhënës nga fusha e historisë. Sipas konkursit nuk është kërkuar një profil i ngushtë i historisë por vetëm 1/3 e orëve janë nga historia pra janë 4 orë histori, 4 orë për lëndë nga metodologjia e shkencave shoqërore dhe 6 orë të tjera nga fusha e hulumtimit shkencor e ku kandidati i zgjedhur nga Senati Sylë UKshini ka përparësi të dukshme me ankuesi sepse kandidati i zgjedhur ka dy doktorata përkatëse të cilat mbulojnë në tersi fushat e lëndëve të shpallura në konkurs.

Senati ka konstatuar se është i paqëndrueshëm vendimi i Komisionit të Ankesave dhe Parashtrësive të Senatit edhe në konstatimin se kandidati Sylë Ukshini nuk është i fushës së historisë.

Senati ka konstatuar se Sylë Ukshini ka doktoruar në Universitetin Shtetëror të Tiranës, në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, në Departamentin e Historisë, ku edhe tema e tij është nga fusha e historisë, drejtimi marrëdhënie ndërkombëtare dhe është mbrojtur para 5 anëtarëve që janë oponentët më të njohur të historisë në Republikën e Shqipërisë nën mentorimin e Prof.Dr. Paskal Milo.

Sylë Ukshini ka qenë bursist studiues nëpër universitete dhe institutet të ndryshme për studimin e Historisë së Evropës Juglindore, ku udhëheqës ka pas historianët më të njohur ndërkombëtar për historinë e shqiptarëve dhe të Ballkanit si Prof.Dr. Karl Kaser, Prof.Dr. Holm Sundhausussen, Prof.Dr. Andresa Kappler, Prof.Dr. Oliver Schmitt, Prof.Dr. Konrad Clewing dhe Prof.Dr. Wolfgang Kopke.

Senati ka konstatuar se Komisioni i Ankesave dhe Parashtrësive ka gabuar kur ka theksuar se është shkelur neni 10 pika 12 e Rregullores sepse kandidati Sylë Ukshini studimet themelore edhe magjistraturën edhe masterin edhe të dy doktoratat i ka në përputhje me lëndët e shpallura në konkurs.

Po ashtu Sylë Ukshini në përputhje me lëndët e shpallura në konkurs i ka edhe monografitë si dhe punimet shkencore, madje të gjitha punimet shkencore i ka nga fusha e historisë.

Në bazë të asaj që u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa në organet e universitetit.



Kryesuesi i Senatit

Prof. Dr. Bajram Kosumi, rektor

Vendimi i dërgohet:

1. Të përmendurit
2. Fakultetit të Edukimit
3. Arkivit